

**Fjala e Kryetarit të Prezencës**

**Trajnim për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në Regjimin e Posaçëm në  
përputhje me të drejtat e njeriut**

30 nëntor 2021

*Vendi: Hotel Xheko Imperial, salla e mbledhjeve Grand Imperial*

*Tiranë, Shqipëri*

Lejomëni që përpara se të mbaj fjalën e përgatitur për veprimtarinë e sotme, t'i shpreh sërish të gjithë qytetarëve shqiptarë, të përfaqësuar këtu prej Ministrit dhe Avokates së Popullit, urimet më të mira për Ditën e Pavarësisë dhe atë të Çlirimit.

***I nderuar Ministër, e nderuar Avokate e Popullit, të nderuar pjesëmarrës,***

Është vërtet mjaft kënaqësi për mua që të jem me ju sot. Vërej se vazhdojmë të përfitojmë nga bashkëpunimi ynë në fushën e Regjimit të Veçantë në burgje nëpërmjet një trajnimi konkret bazuar në gjetjet konkrete të një Vlerësimi të plotë të Nevojave. Falënderoj Ministrin e Drejtësisë për praninë e tij këtu sot, (Faleminderit!) por edhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm me ne. Faleminderit ministër Manja!

Faleminderit edhe ju Avokate e Popullit, zj. Ballanca! Kontributi juaj në veprimtarinë e sotme është gjithashtu shumë i vlefshëm dhe domethënës dhe prej jush pata mundësinë të mësoj shumë gjëra lidhur me këtë temë në një nga takimet tona të para.

Kënaqësia ime shtohet edhe më tej duke vërejtur se si Shqipëria tashmë përfiton nga integrimi i pandërprerë ndërkombëtar nëpërmjet përvetësimit dhe vënies në praktikë të standardeve ndërkombëtare që trajtojnë realitetet e saj, në mënyra konkrete e të përshtatshme për vetë vendin.

Dhe e gjitha kjo është vetëm një vit pasi Shqipëria kryesoi me sukses OSBE-në dhe vetëm pak javë përpara se, për herë të parë në historinë e saj, Shqipëria të bëhet anëtare e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Besoj se puna jonë për Regjimin e Posaçëm është plotësisht në përputhje me këto arritje dhe në fakt po kontribuon deri diku në forcimin e mëtejshëm të kredencialeve ndërkombëtare të Shqipërisë.

Jam veçanërisht i lumtur që shoh shkëmbimin ndërkombëtar të njohurive dhe praktikës me Italinë, një vend që e njoh "relativisht mirë"... me një përvojë shumë specifike në këtë fushë politikash. *Përshëndes Gjeneral Brigade Mauro D'Amico: Duke ju uruar mirëseardhjen, theksoj mirënjohjen time për kontributin tuaj dhe bashkëpunimin tonë, Gjeneral. Faleminderit dhe mirëserdhët në Tiranë!*

Po ashtu, dëshiroj t'ju falënderoj edhe juve Prof. Kurti për kontributin tuaj të rëndësishëm sot.

Dëshiroj ta vlerësoj natyrën konkrete të këtij trajnimi duke e vënë atë në dukje, sepse kështu shmanget një trajtim thjesht teorike i temës, duke u zhytur në realitetin praktik. Kjo është në përputhje me mandatin tonë: t'i ofrojmë mbështetje vendit pritës për nevojat e tij të dalluara qartë!

Dhe ndodh që këto nevoja janë të lidhura me një temë të ndjeshme, sepse bëhet fjalë për balancimin e masave të sigurisë dhe të drejtave të njeriut në fushën e trajtimit të të dënuarve. Që të dyja, edhe siguria edhe ruajtja, janë pjesë përbërëse të përgjegjësisë së shtetit për të mbrojtur personat që u privohet liria.

Nuk dua të jem banal kur them se parimet gjithëpërfshirëse dhe dispozitat ligjore për të drejtat e njeriut në mjediset e burgut duhet të zbatohen konkretisht në praktikë, se siguria dhe kontrolli sigurohen më së miri në mjedise që respektojnë dinjitetin e natyrshëm të të dënuarve dhe paraburgosurve. Parimet e ligshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit duhet të merren parasysh gjatë gjetjes së zgjidhjeve konkrete që garantojnë sigurinë e burgjeve duke respektuar të drejtat e njeriut të të burgosurve. Por në cilat mënyra konkrete i akomodojmë ato dhe nevojën për siguri në burg?

Në OSBE ne kemi një qasje mbarë-shoqërore ndaj projekteve dhe veprimtarive. Është e rëndësishme se si e shohin krimin qytetarët që respektojnë ligjin, sistemin ligjor dhe sistemin e burgjeve. Ajo duhet të merret parasysh në mënyrë të balancuar gjatë hartimit dhe zbatimit të masave specifike të regjimit të posaçëm të burgjeve.

Puna në burg është e vështirë dhe marr shkas këtu për të lavdëruar punën e madhe që personeli dhe policia e burgjeve kryejnë çdo ditë, gjatë gjithë vitit, edhe tani që ne jemi mbledhur e flasim këtu. Ata meritojnë gjithë respektin tonë. Siguria dhe mbrojtja e personelit të burgut dhe e vetë punonjësve të policisë është po aq e rëndësishme.

Jam i sigurt se ky trajnim do t'ju ofrojë mundësinë që t'i jepni përgjigje një sërë pyetjesh, duke gjetur ato lloj përgjigjesh që reflektojnë realitetin shqiptar, ndërkohë që janë plotësisht sipas ligjit dhe angazhimeve ndërkombëtare. Ju lutemi përdorni Raportin e Vlerësimit të Nevojave si udhëzues. Duke pasur parasysh se regjimi i posaçëm i sigurisë së lartë në Shqipëri u fut kohët e fundit dhe ka ende shumë pak të burgosur që i nënshtrohen kësaj mase, është e rëndësishme të sigurohemi që sistemi të funksionojë siç duhet dhe sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Dhe duke qenë se regjimi i veçantë shqiptar është në hapat e tij të parë, mendoj se mund të jetë gjithashtu më e lehtë që të trajtohen që tani një sërë sfidash, duke marrë frymëzim (jo thjesht duke kopjuar) nga vende të tjera me përvojë më afatgjatë në këtë fushë.

Ju uroj të zhvilloni një trajnim sa më produktiv dhe ju nxis që të shkëmbeni pikëpamje që kanë të bëjnë me nevojat tuaja specifike! Shumë faleminderit!